

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ALKET SKËNDAJ



V2021053980445820826

DATE 25/10/2021

NR REP 6069

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 25/10/2021, para meje Noterit ALKET SKËNDAJ, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rr."Reshit ÇOLLAKU", Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane., u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

Amarildo Shehu, atësia Edmond, amësia Xhuma, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në KRUJË, me adresë Laci 00860117; Nd. 5; H. 1; Ap. 7; Fushëkrujë; Fushë Krujë; 1502; Krujë, lindur më 10/09/1988, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032895627 dhe nr. personal I80910070E, .

AKT THEMELIMI date 25.10.2021, STATUT, u noterizuan në emër të Av. Amarildo SHEHU.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit original me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin original.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

ALKET SKËNDAJ

**AKT THEMELIMI**  
**i**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Iceberg Marketing & Trading” (IMT) SH.P.K**

**Neni 1**

**Emri**

- 1.1 Sot, më datë **25.10.2021** krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është **“Iceberg Marketing & Trading” (IMT) Sh.p.k**, në vijim e referuar shkurt si **“Shoqëria”**. Emri tregtar i shoqërisë është **ICEBERG**.

**Neni 2**

**Themelimi.**

- 2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

**Neni 3**

**Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Jordan Misja” Pll. Otto, H1, Apt. 11, Tirane, Albania.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4**

**Ortakët e Shoqërisë**

- 4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:
1. **Z.SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED** shtetas Egjiptian lindur me 17.04.1972 ne Aleksandri identifikuar me pasaport Nr. A04220910 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej **1000 LEKE** (*nje mije leke*), të cilat përfaqësojnë **100 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **1000 Lekë** (*nje mije*), i ndarë në **1 (nje) kuota**, me vlerë sipas nenit 4 me sipër.

- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para, plotësisht të nënshkruara dhe paguara dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë sipas Nenit 4 të këtij Akti Themelimi.
- 5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutore, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji dhe/ose statutit.

## **Neni 6 Objekti**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon: “Import dhe eksport i mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industrial. Shitje mallrash me shumicë dhe pakicë. Real Estate, ndërtimi , përmirësim dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme. Agjenci Udhëtimi dhe shërbime të ndryshme turistike. Kancelari, Shërbime Konsulente dhe Marketingu, Shërbime IT dhe shitje të paisjeve elektrike dhe elektronike, aplikacione. Prodhim dhe shitje mobiljesh, Menaxhim Hotelsh, Resortesh Turistik dhe çdo strukture tjetër akomoduese. Bar -Restorant. Organizim Eventesh, Automjete me Qira, si dhe çdo aktivitet tjetër i cili realizon të ardhura dhe nuk bie në kundërshtim me ligjin Shqiptarë etje”.

## **Neni 7 Kohëzgjatja**

7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

8.1 Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj sikurse parashikohet në Statut dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë:

**1. Z.SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED** shtetas Egjiptian lindur me 17.04.1972 në Aleksandri identifikuar me pasaport Nr. A04220910 madhore dhe me zotesi të plote për të vepruar.

- 9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët emërohen dhe/ose shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Ligji i Zbatueshëm**

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

*Smyoumés*

**SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED**





## STATUTI

### I

## “Iceberg Marketing & Trading” (IMT) Sh.p.k

### Neni 1

#### Emërtimi

1.1 Emërtimi i shoqërisë është “Iceberg Marketing & Trading” (IMT) Sh.p.k me poshtë e referuar si “Shoqëria”.

### Neni 2

#### Personaliteti juridik

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### Neni 3

#### Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Jordan Misja” Pll. Otto, H1, Apt 41, Tirane. Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyrë dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyrë në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### Neni 5

#### Objekti

5.1 Objekti i shoqërisë do të konsistojë në: “Import dhe eksport i mallrave të ndryshëm ushqimorë dhe industrial. Shitje mallrash me shumicë dhe pakicë. Real Estate, ndërtimi, përmirësim dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme. Agjenci Udhëtimi dhe shërbime të ndryshme turistike. Kancelari, Shërbime Konsulente dhe Marketingu, Shërbime IT dhe shitje të paisjeve elektrike dhe elektronike, aplikacione. Prodhim dhe shitje mobiljesh, Menaxhim Hotelsh, Resortesh Turistikë dhe cdo strukture tjetër akomoduese. Bar -Restorant. Organizim Eventesh, Automjete me Qira si dhe cdo aktivitet tjetër i cili realizon të ardhura dhe nuk bie në kundërshtim me ligjin Shqiptarë etje”.

### Neni 6

#### Kapitali i Shoqërisë

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **1000 LEKE** (nje mije). Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar nga ortakët dhe përbëhet në tërësi nga kontribute në para.

6.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetem:

1. **Z.SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED** shtetas Egjiptian lindur me 17.04.1972 në Aleksandri, identifikuar me pasaport Nr. A04220910 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej **1000 LEKE** (nje mije leke), të cilat përfaqësojnë **100 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

6.3 Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut.

6.4 Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar. Kur Ortaku ka shlyer plotësisht kontributin e tij, ai nuk ka asnjë përgjegjësi financiare ndaj shoqërisë ose të tremeve.

### Neni 7

#### Zmadhimi i kapitalit

7.1 Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 13 të këtij Statuti.

7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë. Në çdo rast këto kontribute duhet të shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi të kontributeve të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

#### **Neni 8**

##### **Zvogëlimi i kapitalit**

8.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me propozim të administratorit/ëve, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

8.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit sipas nenit 13 të këtij Statuti.

#### **Neni 9**

##### **Transferimi i kuotave**

9.1 Transferimi i kuotave ose pjesëve të tyre të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, dhurim ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

#### **Neni 10**

##### **Transferimi tek personat e tretë**

10.1 Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje ose me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

10.2 Në rast mosmarrëveshje midis palëve, vlera e kuotës që transferohet mund të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakord.

#### **Neni 11**

##### **Asambleja e Përgjithshme**

11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

11.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

11.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

11.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

11.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme.

11.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtëzakonshme.

#### **Neni 12**

##### **Asambleja e Zakonshme**

12.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.



12.2 Vendimet e zakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 50% të kapitalit të Shoqërisë.

12.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 12.2, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Nëse edhe në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi i kërkuar, ortakët e pranishëm përbëjnë kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.

### Neni 13

#### Asambleja e Jashtëzakonshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtëzakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.

13.2 Vendimet që kanë të bëjnë me *(por pa u kufizuar vetëm në to)*: ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.

13.3 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sic janë ceshtjet e parashikuara në paragrafin 13.2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë jo më pak 80% të kapitalit të shoqërisë janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

13.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 13.3, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

### Neni 14

#### Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi

14.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e një vote në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Vota e secilit prej ortakëve është e barabartë me vlerën e kontributeve të nënshkruara dhe shlyera dhe përlogaritë në proporcion me përqindjen e zotëruar dhe që përfaqëson në kapitalin e Shoqërisë.

14.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Personi i autorizuar mund të jete i pranishëm në mbledhje fizikisht ose virtulisht nepermjet komunikimit elektronik audjoviziv.

14.3 Pjesëmarrja në mbledhjet e Asamblesë për ortakut që nuk janë të pranishëm fizikisht mund të realizohet edhe nepermjet mjeteve të ndryshme të komunikimit elektronik, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve dhe komunikimi të jete në kohe reale..

### Neni 15

#### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

15.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a. përcaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshimin e Statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j. shpërndarjen e fitimeve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;

- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;  
m. çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

#### Neni 16

##### Administratori/ët

16.1 Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast të administrimit të Shoqërisë nga dy administratorë, Shoqëria do të administrohet vec e vec ose bashkarisht nga të dy administratorët sipas ligjit

16.2 Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

16.3 Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

16.4 Administratori i parë i Shoqërisë është:

**Z. SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED** shtetas Egjiptian lindur më 17.04.1972 në Aleksandri, identifikuar me pasaportë Nr. A04220910 madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

#### Neni 17

##### Kompetencat e Administratorit/ëve

17.1 Administratori/ët është/janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm.

17.2 Administratori/ët ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.

17.3 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë ushtrimin e kompetencave të administratorëve, në rast se ka më shumë se një administrator, ato i ushtrojnë kompetencat veç e veç ose se bashku.

17.3 Administratori/ët ka/në kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a. mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b. përfaqëson Shoqërinë;
- c. kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- d. përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e. siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f. siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të certifikuar dhe raporti i llogaritarëve publikë të certifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- h. raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
- i. kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

#### Neni 18

##### Viti ushtrimor financiar

18.1 Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor 2021.

#### Neni 19

##### Shpërndarja/likuidimi



19.1 Për shpërndarjen e Shoqërisë, në çdo kohë dhe për çdo arsye, si dhe për likuidimin dhe për emërimin e likuidatorëve, do të vendoset sipas dispozitave të ligjit shqiptar në fuqi.

#### Neni 20

#### Dispozita të përgjithshme

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar të zbatueshëm në fushën e shoqërive tregtare.

20.2 Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo konflikt që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, në rastet e përgjegjshmërisë, dhe raste të tjera, do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të gjykatave shqiptare.

20.3 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

22.4 Ky Statut është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe Anglisht, më vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar, më datë 25. 10 .2021

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

*Smyoumés*

**SAMER MAHMOUD YOUNES MOHAMED**

